



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 108 Prot

Tiranë, më 29.08.2008

VENDIM Nr. 12 dt. 26.08.2008

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 26.08.2008, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

I. Ju bë me dije anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, konkluzioni i grupit të punës i ngritur nga Ministri Ylli Pango, lidhur me statusin e disa monumenteve të kulturës të Kat. II, në Elbasan:

3	Banesë	(hiqet nga lista e monumenteve)
4	Banesë	(hiqet nga lista e monumenteve)
5	Banesë (ndërtim i ri)	(hiqet nga lista e monumenteve)
16	Banesë (ndërtim i ri)	(hiqet nga lista e monumenteve)
17	Banesë (ndërtim i ri)	(hiqet nga lista e monumenteve)
22	Muzeu	(KAT. I)

II. Të miratojë projektet:

1. Projekt ide për përshtatjen e disa ndërtesave ekzistuese në Qendrën historike të Gjirokastrës, në funksion të Universitetit të Gjirokastrës, Eqerem Çabej.
2. Projekti i ndërtimit të mjediseve të reja të Universitetit të Gjirokastrës Eqerem Çabej në Qendrën historike të Gjirokastrës.
3. Restaurim banesa e Petro Markos, Vlorë.
4. Projekti i rikonstruks. të godinës së Parlamentit shqiptar, fasada.
5. Diskutimi i projekt idesë së rikonstruksionit të Bankës së Shqipërisë, Tiranë.
6. Projekt mbi rijetëzimin në kalanë e Kaninës, Vlorë.

III. Të miratojë projektet e restaurimit

1. Restaurim xhamia e Mirahorit, Korçë. (Projekti strukturor si plotësim i projektit arkitekturor të miratuar me vendimin e KKR nr. 8, dt. 08.04.2008)
2. Restaurim Teqeja e Melanit, Gjirokastrë.
3. Paketa e mirëmbajtjes së monumenteve të kategorisë së I, Gjirokastrë.
- Banesa Bejo Beqiri, - Pazari, banesa Agron Kokalari, - Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës, - Pazari, rruga Fantazia, - Hotel Sopoti, - Banesa Farije

- Duro (Musinë Kokalari), - Pazari, rruga DRKK-Packart, - Banesa Kokobobo, - Labova e Kryqit
4. Restaurim kisha e Shën Mëhillit dhe rruga për në kishë, Berat.
 5. Paketa e mirëmbajtjes së monumenteve në Qendrën historike Berat.
 - Porta jugore e qendrës mesjetare, - Restaurimi i fasadës së Sotiraq Shkrepit, -
 - Porta e banesës së Z. Nikollaq Haxho, - Restaurim i pjeshëm i fasadës së banesës së Ilir Decollit, - Banesa e Taqi Simsisë, - Muri pranë banesës së Loli Bendos
 - Fasada e banesës së Thoma Kajana, - Balli i dyqaneve në Mangalem
 6. Restaurim kisha e Shën Mëhillit, Voskopojë, Korçë.
 7. Konservim dhe restaurim kisha e Shën Pjetrit, Voskopojë, Korçë.
 8. Restaurim i xhamisë së Gjini Aleksit Rusanj, Delvinë, Sarandë.
 9. Kisha e Shën Stefanit, Dhërmi, Vlorë.
 10. Restaurimi i kalasë së Porto Palermos, Himarë, Vlorë
 11. Bazilika e 40 shenjtoreve, Sarandë. Konsolidim, rrethim.
 12. Restaurim Bazilika, Sinagoga, Sarandë.
 13. Xhamia e Allajbegisë, Dibër
 14. Restaurim xhamia e Plumbit, Shkodër.
 15. Restaurim kisha xhami, Shkodër
 16. Restaurim Amfiteatri i Durrësit.
 17. Ndërhyrje restauruese në xhaminë e pazarit Krujë.
 18. Paketa e projekteve të restaurimit të ZAKPA Apoloni: - Pastrimi dhe restaurimi i kullës së rrumbullakët A në hyrje të qytetit antik të Apolonisë, -Pastrimi dhe konservimi i faltores A në agoranë e qytetit antik të Apolonisë, Projekt për konservimin e murit të Amforave” Apoloni
 19. Sistemim dhe përmirësim i territorit rreth godinës të PA Antigone.
 20. Kërkesë e parkut arkeologjik të Bylisit mbi ndryshimin e preventivit të projektit ndërhyrjet në bazilikën B,C,E të qytetit antik të Bylisit, për shkak të prokurimit të projektit.

IV. U miratuan kërkesat për pajisje me licensë sipas kategorive:

- | | |
|-------------------|-------------|
| 1. Ajet Nallbani | Kategoria A |
| 2. Hasan Nallbani | Kategoria B |

V. Nuk u miratuan:

1. Projekti ndërtimi i murit rrethues, muzeu Etnografik Krujë. (Të ngrihet një grup pune dhe të verifikojë ku do të ndërtohet muri rrethues)
2. Kërkesa për shfrytëzimin e një pjese të Rotondës, Durrës

VI. Nuk u diskutuan

A) Kërkesat

1. Restaurim i pikturës murale (A Secco), në muzeun Etnografik, Krujë.
2. Kërkesa e Bashkisë së Tiranës, për miratimin e projekt idesë fituese “Për Rehabilitimin e Sheshit Skënderbej”.
3. Largimi i shkëmbit në murin e kalasë së Rozafës, Shkodër

4. Restaurimi i ambienteve të brendshme të godinës Omarati, Q.Pazarit, Gjirokastër.
5. Restaurimi i banesës Thanas Dino, Gjirokastër.
6. Restaurimi i banesës Stefan Tushe, Gjirokastër.
7. Restaurim banesa Vangjel Kaftani, Gjirokastër
8. Projekt përshtatje, Lokal Lagjia "11 Janari", pronar; Dashnor Mullai, Gjirokastër.
9. Projekt rikonstruksioni i banesës së Z. Durim Nepravishtës (zonë tampon), Berat.
10. Projekt përshtatje e objektit Vasil Merdani (zonë tampon), Berat.
11. Projekti i restaurimit të rrënojave të banesës më pronar Vefik Kadena, Berat
12. Restaurim i banesës, pronar Halil Ymer Myderrizi, Durrës.
13. Projekt rikonstruksioni, Vila 2 kate, pronar Fatmir Lama, lagja Kala, Elbasan.
14. Rikonstruksion i banesës për tu kthyer në Galeri Arti, Elbasan
15. Projekti i rikonstruksionit elektrik dhe të ndriçimit në Galerinë e Armëve në Kalanë e Gjirokastrës.
16. Rikonstruksion banese me pronar Sofokli Naçi, Korçë.
17. Hotel Colosseo, Shkodër
18. Bar Piazza, Shkodër

B) Diskutimi i rregullores për zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në restaurim.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
YLLI PANGO

SEKRETAR I K.K.R.

LORENC BEJKO

